

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“TAHIRSYLAJ MINERAL” SH.P.K.

Isniq, K. Deçan



FABRIKË PËR AMBALAZHIMIN E UJIT NATYRAL

Investitori: **“TAHIRSYLAJ MINERAL” SHPK**

Adresa : **Rr. Sali Çeku, nr. 60, Dardania, Pejë**

Pronar: **Bislim Tahirsylaj**

Deçan, Prill – 2023

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR

FABRIKËN E AMBALAZHIMIT TË UJIT NATYRAL

Parcelat nr. 01841-2 dhe 01843-0, Zona kadastrale, Isniq, Komuna Deçan

Investitori:	Emri	Hartuese e Raportit të VNM-së
<i>Aplikuesi</i>	Arsim Tahirsylaj	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
<i>Investitori:</i>	“TAHIRSYLAJ MINERAL” SH.P.K.	Glllogoc +383 49 588 634 Blerinabajraktari3@gmail.com
<i>Adresa:</i>	Rr. Sali Çeku, nr. 60, Dardania, Pejë	
<i>Lokacioni i Fabrikës</i>	Isniq, Komuna Deçan	
<i>Tel:</i>	+383 49 566 999	
<i>Email:</i>	arsimtahirsylaj@hotmail.com	

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Deçan, Prill - 2023

Përmbajtja:

1.	HYRJE	1
a)	Vendndodhja e Projektit.....	1
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	3
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit.....	5
d)	Përllogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit	7
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	9
3.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	10
4.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	12
	Menaxhimi i ujit -	13
	Menaxhimi i mbeturinave	16
5.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	17
5.1	Ndikimet në ajër	17
5.2	Ndikimet në tokë.....	18
5.3	Ndikimet në ujë	19
6.	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	20
7.	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	20
8.	Ndikimet nga zhurma.....	21
9.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	21
10.	Erozioni.....	21
11.	Pasuritë Materiale	22
12.	Trashëgimia Kulturore	22
13.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	23
14.	PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	24
15.	PERSHKRIMI I MASAVE.....	27
16.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	27
17.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	27
18.	Masat për mbrojtje nga zhurma	28
19.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	28
20.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	28
21.	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	29

22.	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	29
23.	Menaxhimi i mbeturinave	30
24.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	31
25.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	31
26.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	32
27.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT:	33
28.	LITERATURA E PERDORUR	34

Lista e Figurave:

Figura 1	Fabrika e Ambalazhimit te ujit natyral "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.	1
Figura 2	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "Tahirsylaj Mineral" sh.p.k	2
Figura 3	Lokacioni i Kompanisë "Tahirsylaj Mineral" sh.p.k. nga komuna e Deçanit	2
Figura 4	Ortofoto dhe Harta topografike e parcelës ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë	3
Figura 5	Objekti i Kompanisë "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.....	3
Figura 6	Planimetria e fabrikës për ambalazhimin e ujit "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.	4
Figura 7	Holli i fabrikës se prodhimit te ujit te ambalazhuar "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.	4
Figura 8	Makineria për pastrimin e Ujit dhe përgatitjen e tij për mbushje ne shishe (Prodhim Kinez).....	5
Figura 9	Procesi teknologjik i pastrimit te ujit (Prodhim Kinez).....	5
Figura 10	Makina për mbushjen e shisheve (Prodhim Kinez).....	6
Figura 11	Makineria e Paketimit.....	6
Figura 12	Dimensionet e Fabrikës “ Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k.	11
Figura 13	Rrjeti Hidrografik i komunës së Deçanit.....	15

1. HYRJJE

Synimi i këtij projekti është, Funksionalizimi i fabrikës së ambalazhimit të ujit natyral në parcelën me nr. 01841-1 dhe 01843-0 zonën kadastrale Isniq, të K. Deçan. Fabrika e ambalazhimit të ujit është e ndërtuar por ende nuk ka filluar te punoj ndërsa në fillim te punës parashihet të ketë një fuqi totale të ambalazhimit prej 10,000 - 20,000 l/ditë, e cila do ti shfrytëzoj ujerat nëntokësore nga pusi nëntokësor.

Duke u bazuar në rritjen e kërkesave si nga bizneset e po ashtu edhe nga popullata në lidhje me përdorimin e ujit natyral si dhe mundësia e eksportit te ujit jashtë vendit.



Figura 1 Fabrika e Ambalazhimit te ujit natyral "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.

Zona e fabrikës se ambalazhimit nga kompania “TAHIRSYLAJ MINERAL” SH.P.K. ndodhet ne zonën kadastrale te Isniqit, ndodhet në Veri të komunës së Deçanit përkatësisht në parcelën me nr. 01841-1 dhe 01843-0 zk. Isniq, K. Deçan, afërsisht 3.6 km nga komuna e Deçanit.

a) Vendndodhja e Projektit

Objekti i Fabrikës së ambalazhimit te ujit natyral ndodhet në ngastrën me nr. 01841-1 dhe 01843-0, Zona kadastrale Isniq Komuna e Deçanit. Kompania “TAHIRSYLAJ MINERAL” SH.P.K. ndodhet në territorin administrativ të komunës Deçanit.




Figura 2 Shtirija hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "Tahirsylaj Mineral" sh.p.k




Figura 3 Lokacioni i Kompanisë "Tahirsylaj Mineral" sh.p.k. nga komuna e Deçanit



Figura 4 Ortofoto dhe Harta topografike e parcelës ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Objekti i Kompanisë do të ketë këtë përbërje:

- Administrata,
- Holli i prodhimit



Figura 5 Objekti i Kompanisë "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.

Operimi dhe mirëmbajtja nuk kanë kosto të larta dhe se nuk ndikojnë në ambient, për arsye se në atë zonë nuk ka shtëpi afër e po ashtu kompania ka marrë të gjitha masat duke e ruajtur ambientin, ku për mbeturina komunale ka planifikuar kontejner ndërsa për ujëra të ndotura ka planifikuar ndërtimin e një impianti të vogël ku do të trajtojë ujërat e ndotura para se ato të shkarkohen në recipient.

Objekti i fabrikës se ambalazhimit ka një sipërfaqe prej 1,272.6 m², objekti i administratës dhe Depos ka sipërfaqe prej 267.12 m². Objekti i hangarit ku është vendosur linja për ambalazhimin e ujit është e ndërtuar me konstruksion montazh nga konstruksioni i çelikut, i mbuluar me sandwichpanele e po ashtu e veshur me panele te fabrikuara, ndërsa administrata është e ndërtuar me materiale ndërtimore siç janë beton armeja dhe muret me blloka te argjilës.




Figura 6 Planimetria e fabrikës për ambalazhimin e ujit "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.




Figura 7 Holli i fabrikës se prodhimit te ujit te ambalazhuar "Tahirsylaj Mineral" Sh.p.k.

Shihet qarte se fabrika është e ndërtuar sipas normave dhe standardeve e cila ka hapësira gjelbëruese për rreth objektit dhe po ashtu rruga është projektuar qe ti mbledh ujerat ne një pike

te caktuar ti trajtoj ato para se te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimit, lokacioni ku është ndërtuar fabrika e ambalazhimit te ujit është lokacion shumë i qete larg shtëpive dhe se fare nuk do te ndikoj ne popullatë apo mjedis.

Kjo veprimtari, vlerësohet se do të ketë ndikimin shume shume te vogël në mjedis.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Fabrika për ambalazhimit te ujit natyral, pritet te filloj punën nga viti 2023 e cila është ne fund te finalizimit te projektit.

Me poshtë paraqesim përshkrimin e aktivitetit të Fabrikës për ambalazhimin e ujit natyral janë:
Te gjitha me radhe:



Figura 8 Makineria për pastrimin e Ujit dhe përgatitjen e tij për mbushje ne shishe (Prodhim Kinez)




Figura 9 Procesi teknologjik i pastrimit te ujit (Prodhim Kinez)



Figura 10 Makina për mbushjen e shisheve (Prodhim Kinez)



Figura 11 Makineria e Paketimit

Sa i përket komponentëve kryesore, për ambalazhim të ujit janë:

- 🔌 Energjia elektrike,
- 🔌 Uji.

Rëndësia e energjisë elektrike është primare sepse pa të nuk funksionon asgjë, e gjithashtu rol të rëndësishëm luan edhe uji sepse përdoret si për prodhim ashtu edhe për pastrim të makinerive

dhe dyshemesë, ndërsa sa i përket dheut, objekti është ndërtuar 2022 dhe normal qe ne atë vit është përdorur dheu për rregullimin e hapësirave gjelbëruese ndërsa për gjera tjera nuk është përdorur.

Sa për fillim është planifikuar te fillohet me ambalazhim te ujit natyral:

Sa i përket biodiversitetit ne atë lokacion nuk është shume i zhvilluar për arsye se zona ku është fushore dhe nuk është dhe aq e zhvilluar.

d) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së ndërtimit dhe operimit

Me poshtë do ti përshkruajmë te gjitha emetimet e pritura gjate fazës se ndërtimit dhe gjatë operimit:

-  **Uji** – Kualiteti i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së nuk ka ndikuar negativisht gjate fazës se ndërtimit por nuk pritet te ketë ndikim negativ as gjate fazës se operimit, ndotja mund te jetë minimale. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për ambalazhim ne shishe por edhe për proces teknologjik te pastrimit te makinerive me ane te sistemit automatik, pastrim te dyshemesë si dhe për nevoja sanitare dhe higjienike dhe nuk përdoret për qëllime tjera. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për nevoja sanitare pas përdorimit te tij do te shkarkohet ne rrjetin e kanalizimit te fshatit pas trajtimit ne impiantin e ndërtuar nga kompania. Ndikimi kryesor i ndotjes se ujerave janë shkarkimet e ujerave te pa trajtuara ne mungesë te impianteve nga shtëpitë ne fshatin ku është ndërtuar fabrika e amabalazhimit te ujit “Tahirsylaj Mineral” SH.P.K.
-  **Ajri** - nga aktivitet e punës gjate ndërtimit nuk ka pasur dhe priten ndikime të theksuara në ajrin ambiental. Ky aktivitet nuk parasheh përdorimin e lëndëve djegëse të dëmshme, nuk parasheh ndonjë proces teknologjik të përpunimit të produkteve industriale apo kimike dhe realisht nuk paraqet potencial për ndikime në kualitetin e ajrit. Ndikime minimale kane ndodhur gjate fazës se ndërtimit, në kualitetin e ajrit brenda parcelës se ndërtimit, gjate sjelljes se materialeve ndërtimore te parafabrikuara me kamionë.
-  **Dheu** – duke konsideruar kapacitetet e projektuara të fabrikës së ambalazhimit te ujit, dhe si rezultat i investimit adekuat – parashihet qe ujerat e shkarkuara nga te gjitha sipërfaqet operative te largohen me ane te gypave dhe te shkarkohen ne impiant pas trajtimit te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimit te fshatit, dhe nuk do te kenë fare ndikim me token – dheun, mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën dheut janë minimale, duke pas parasysh edhe aktivitetin e punës ndotja e dheut nuk ekziston fare ne kompaninë “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k..

-  **Zhurma** – gjate ndërtimit e po ashtu edhe gjate operimit nuk ka patur Zhurmë e po ashtu gjate operimet parashihet qe zhurma do te jete minimale sepse makineritë nuk janë te mëdha dhe nuk lëshojnë zhurme te madhe. Zhurma e makinerive është nen Db te lejuar.
-  **Dridhjet** – Dridhjet të tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim. Dukuritë tjera, që shpesh ndodhin në territorin e Deçanit, janë: rrëshqitja e dheut, akullnajat, ortekët e borës, breshëri, si dhe dukuri tjera që shkaktojnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.
-  **Drita, nxehtësia dhe rrezatimi** – Janë tri dukuri qe te triat se bashku te ndihmojnë ne realizimin e punës ku Lokacioni ku është ndërtuar fabrika ka drite, rrezatim diellor dhe nxehtësi te mire dhe për këtë arsye kompania e shpenzon energji sepse përdor drite nga dielli nxehtësi po ashtu nga dielli.
-  **Flora dhe Fauna** – Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë.
-  **Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku shume qytetar janë te punësuar tani dhe përfitojnë paga dhe mëditje te mira. Ky Projekt ka ndikuar pozitivisht në ekonominë Vendore dhe lokale.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e fabrikës së ambalazhimit të ujit dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), Fabrika apo hangari është ndërtuar për per ambalazhim e cila ne fund te vitit 2022 ka përfunduar dhe eshte kompletuar me te gjitha makineritë per ambalazhim te ujit natyral, i cili tani është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje te tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi administrativ nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.
- Udhëzimi administrativ-nr.05/2013 Për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra
- Udhëzimi administrativ- nr. 07/2015 Për menaxhimine mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore
- Udhëzimi administrativ-nr. 27/2014 Për ambalazhin dhe ambalazhet mbeturinë
- Udhëzimi administrativ-nr. 15/2012 Për menaxhimin edeponive të mbeturinave
- Udhëzimit Administrativ nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.
- Udhëzimi administrativ 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit te ujerave te ndotura ne rrjetin e kanalizimit dhe ne trupin uJOR.
- Udhëzimi administrativ 04/2018 për pengimin e aksidenteve te mëdha ku përfshihen

substancat e rrezikshme.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Kompania “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k. gjatë hulumtimit të burimeve të ujit në pronën e sajë e ka vërejtur se ka potencial të mjaftueshëm të ujërave nëntokësor, pas hapjes së pusit nëntokësor janë bërë analizat e sasisë dhe cilësisë së ujit, të cilat kanë dale shumë të kënaqshme dhe duke qenë se prona është në afërsi të qytetit si dhe kërkesat për ujë natyral çdo ditë e më shumë janë duke u rritur, këto kanë qenë arsye kryesore të zgjedhjes së kësaj alternative më të arsyeshme sepse kompania “Tahirsylaj Mineral” ka hulumtuar edhe vende tjera por kostoja ka qenë shumë e lartë dhe analizat e burimeve të ujit nuk kanë qenë të kënaqshme.

Përzgjedhja e lokacionit të kompanisë është bërë për shumë arsye:

- Prona private e kompanisë,
- Ambienti i pastër,
- Cilësia e ujit shumë e mirë,
- Si dhe kosto e operimit më e ulët,
- Makineri mesatare dhe shumë të mira me prodhues kinez.

Teknologjia e përdorur është e qëndrueshme me çmime mesatare jo të larta të cilat kryejnë funksionin shumë mirë.

Përzgjedhja e dimensioneve të fabrikës kanë qenë kushtëzuar nga parcelat e kompanisë por edhe nga linja e ambalazhimit të ujit. Dimensionet e fabrikës janë: Hangari i Ambalazhimit B = (50.50 x 25.20) metra dhe administrata (25.20 * 10.60) metra si në figurën e mëposhtme.




Figura 12 Dimensionet e Fabrikës “ Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k.

Ndërsa sa i përket efekteve mjedisore ky objekt ka ndikuar pak fare ne mjedis sepse aty kane qene fusha dhe ara ku janë mbjella kultura te ndryshme te drithërave ndërsa tani është ndërtuar fabrika e ambalazhimit e cila sado pak ka ndërhyrë ne mjedis, por duke pasur kujdes ne mirëmbajtje te fabrikës si dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe gjelbërimit mund te mos vërehen fare ndikimet ne mjedis, ndërsa fabrika është ndërtuar nga materialet e parafabrikuar te cilat kane ardhur direkt dhe janë vendosur ne vend punishte nuk është përdorur material i fort ndërtimor, përpos kulmit qe është nga konstruksioni metalik kapriat ku ky konstruksion përdoret për mbulimin e hapësirave te mëdha, ndërsa administrata është ndërtuar me material ndërtimor siç janë: Betoni, armatura, bllokat nga argjila dhe materialet tjera.

4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit paraqet situatën e tregueseve të komponentëve kryesor të mjedisit, si: toka, uji, ajri, biodiversiteti etj. Veprimtaria e vazhdueshme e njeriut ka sjellë ndikim në këta komponentë, duke ndryshuar gjendjen e tyre natyrore. Në Komunën tonë, si pasojë aktiviteteve të ushtruara nga faktori njeri, janë dëmtuar në masë të madhe fondi pyjor, degradim i lumenjve dhe brigjeve të tyre, sipërfaqet e gjelbëruara nga hedhja e mbeturinave etj. Gjendja e “Lumëbardhit” të Deçanit dhe “Lumëbardhit” të Lloqanit nuk është aq e mirë, nga shfrytëzimi pa kriter i rërës dhe i zhavorrit, i hedhjes së mbeturinave, derdhja e ujërave të ndotura (zeza) kanë ndikuar në cilësinë dhe sasinë e ujit. Mbeturinat e hedhura përgjatë - lumenjve, projeve, prrockave, kanaleve të ujitjes, si dhe depozitimi i tyre ndikon në ndotjen e tyre, po ashtu shfaqjen e dukurive si, erozioni dhe vërshimet në tokat bujqësore, që shtrihen përgjatë këtyre lumenjve. Burim kryesor në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në Komunën tonë janë mungesa e sistemit të kanalizimit për ujërat e ndotura (zeza), në pjesën urbane, ashtu edhe në pjesën rurale. Në gjithë pjesën rurale mungon sistemi i kanalizimit, ujërat e ndotura grumbullohen në gropat septike, të cilat nuk janë të ndërtuar sipas kriterëve të ndërtimit. Ato më shumë janë gropa grumbulluese, që mund të ndikojnë në ndotje të ujërave nëntokësore, por edhe në ato sipërfaqësore. Problemi më serioz është në ato fshatra që kanë mungesë të rrjetit të ujësjellësit dhe furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga puset. Largësia e stallave të kafshëve, mbeturinat organike, nuk janë aq larg nga puset, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ujit të pijes. Kanalizimi për ujërat e ndotura, në pjesën urbane faza e parë e tij ka përfunduar, në të përveç Deçanit janë të kyçura edhe këto fshatra: Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ultë, Belegu, Llukë e Epërm, Llukë e Ultë dhe Lumëbardhi. Gjithashtu, administrimi i dobët i mbeturinave ka bërë që ndikimi në mjedis dhe në shëndetin e njeriut janë të konsiderueshme, të pranishëm edhe në komponentët kryesor të mjedisit (tokës, ujit, ajrit dhe biodiversiteti). Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin rrezik permanent për banorët e Komunës tonë. Gjithashtu, mbeturinat biodegradueshme përmes zbërthimit (dekompozimit) të tyre çlirojnë në ajër gazra të dëmshme, si CH₄, (metan) dhe CO₂ (dyoksid i karboni). Mirëpo, problem më i madhe në deponitë ilegale janë zjarret e pakontrolluara, të cilat çojnë në lirimin e gazrave toksike (dioksinë) të dëmshme për mjedisin, por edhe për shëndetin e njeriut. Është i domosdoshëm riciklimi i mbetjeve është ndarja e tyre në burim, i cili duhet të fillojë që nga mbledhja mbeturinave nga ekonomitë shtëpiake. Caktimi i deponimeve lokale për mbeturina inerte (ndërtimet dhe prishjet), do të mundësojë menaxhim më të mirë të tyre. Nuk ka trajtim për mbeturinat e rrezikshme, insinerator për djegien e mbeturinave spitalore (qendrave të mjekësisë familjare). Këto

mbeturina depozitohen bashkë me mbeturinat urbane. Sasia e mbeturinave urbane për kokë banorit është 0.30 kg mbetje për banorë.

Ajri - Ndotësit e ajrit janë kimikatet, grimcat e pluhurit ose materiet biologjike që shkaktojnë dëmtime ose shqetësime tek njerëzit dhe organizmat e tjerë apo shkaktojnë dëme në mjedisin natyror në atmosferë. Efektet shëndetësore shkaktuar nga ndotësit e ajrit klasifikohen si të ndryshme fiziologjike dhe biokimike të lehta deri në vështirësi në frymëmarrje (raspiatore) dhe probleme të ndryshme kardiake. Burimet e ndotjes së ajrit mund të jenë natyrore ose antropogjenë. Ndotësit kryesor të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit si NO_x, SO₂ dhe benzeni emitohen nga djegia e lëndës fosile për energji dhe transport. Njëri ndër problemet kryesore që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve si: CO₂, NO_x, SO₂, CO. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda.

Zhurma - Zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme për këtë zonë. Komuna nuk ka pajisje për matjen zhurmës. Burimi kryesor i zhurmës vjen nga komunikacioni dhe ka efekt negativ. Në planin zhvillimor të Komunës janë planifikuar zonat e mbrojtura nga zhurma. Në këto zona nuk do të lejohet ndërtimi dhe lejimi i aktiviteteve të subjekteve afariste, që shkaktojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara me ligj. Këtë e vërteton edhe hulumtimi në terren, ku ndotja nga zhurma është theksuar si ndotësi më i madh, me 50 %.

Menaxhimi i ujit - Furnizimi me ujë të pijshëm Ndërmarrja e ujësjellësit menaxhon me rrjetin e ujësjellësit që ofron shërbime për qytetin e Deçanit dhe 25 fshatrave, me numër të konsumatorëve prej 5.360, koha e shërbimit - ofrimit të ujit të pijshëm është 24 orë, pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme të tjera (prishje për arsye të ndryshme). Burimet e marrjes së ujit janë burimet natyrore të cilat janë të kaptuara, kurse për nga cilësia e ujit cilësohen jashtëzakonisht të pastra. Uji i ofruar për zonën e shërbimit, të cilën e mbulon kjo ndërmarrje i plotëson standardet e ujit të pijshëm, sipas analizave kimike dhe bakteriologjike që bëhen nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë së Kosovës dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), si dhe rregulloreve dhe normave të IKSH. Metoda e pastrimit/përpunimit të ujit është vetëm me sistemin e klorifikimit në stacionet e klorinimit.

Rrjeti i ujësjellësit – Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizimi me ujë të pijshëm është 189 km. Materiali i ndërtimit: pjesa dërmuese është nga materiali polietilen, kurse pjesa tjetër PVC dhe asbest-tipi C dhe B të cilët medoemos duhet të ndërrohen. Numri i rezervuarve

8 prej tyre 5 janë të ndërtuara nga betoni, kurse 3 nga llamarina. Burimet ekzistuese të furnizimit-burim natyror.

Rrjeti i kanalizimit atmosferik - Gjendja ekzistuese Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit atmosferik është i shtrirë vetëm në qytetin e Deçanit, i cili është projektuar dhe ndërtuar gjatë vitit 2007-2008, i cila ka përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Materiali i ndërtimit është i llojit PVC $\varphi=200-1000$. Ky rrjet i kanalizimit mbulon vetëm qytetin, ndërsa në fshatra ku rrjeti rrugorë është i asfaltuar nuk është i instaluar.

Trajtimi i ujërave të ndotura - gjendja ekzistuese - Trajtimi i ujërave të ndotura është çështja më problematike në Komunën e Deçanit, deri me tani nuk ka qenë e mbuluar me rrjet përkatës. Siç u potencua më lartë, këtë vit është mbuluar një pjesë e vendbanimeve me këtë rrjet, por jashtë rrjetit kanë mbetur edhe 31 fshatra. Në disa prej tyre kanë ndërtuar rrjetet e veta lokale, por pjesa dërmuese përdorë sistemin e gropave septike. Kanalizimi për ujërat e ndotura, i cili është në ndërtim e sipër dhe në të janë lidhur krahas qytetit të Deçanit edhe këto fshatra: Beleg, Cararbreg i Epërm, Carrabreg i Ultë, Llukë e Epërm, Llukë e Ultë dhe Lumbardhë. Disa nga fshatrat kanë të ndërtuar me mjete vetanake kanalizimin për ujëra të ndotura, Strellci Ultë-Lagja Jusaj, Isniq-Lagja Tishukaj, Rastovicë, Gramaqel, Dranoc dhe Hulaj. Pjesa tjetër e popullsisë, afërsisht 60 %, nuk kanë të zgjidhur problemin e ujërave të ndotura. Këto ujëra derdhen në sipërfaqe të hapur në lumenj, përroje dhe kanale të ujitjes. Disa nga familjet kanë të ndërtuar edhe gropat septike, të cilat nuk janë të ndërtuar sipas kriterëve të ndërtimit dhe ato ma shumë janë gropa grumbulluese. Mirëpo, vlerësohet se ato fshatrat që furnizohen me ujë të pijes nga puset (bunarët), kanë ujë të cilësisë jo të mirë, e derdhja e ujërave të ndotura në sipërfaqe të hapur, po ashtu, ato ndikojnë në ndotjen edhe të ujërave nëntokësore.

Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore - Rrjeti hidrografik është mjaft i zhvilluar. Ujërrjedha kryesore sipërfaqësore janë; Lumëbardhi i Pejës, Deçanit, lumi Erenik, me një numër të madh të përrenjve të cilat rrjedhin në pjesët e larta malore. Të gjitha këto ujërrjedha kanë drejtim të rrjedhjes veri-veriperëndim dhe jug-jug lindje. Lumëbardhi i Pejës – buron në Usovishtë, në lartësi mbidetare 1932m (Pasha, 1975). Formon rrjedhën e tij duke prerë në formë kanioni formacionet gëlqerore të Grykës së Rugovës. Pellgu ujëmbledhës i këtij lumi është 503,5 km² (Labus, 1979). Lumëbardhi i Pejës merr pjesë me 11.5%, në sipërfaqen e përgjithshme të basenit të Drinit të Bardhë, koeficienti i rrjedhjes 0,70, ndërsa moduli i rrjedhës 26,5 l/s/km² (Pllana, 1991). Sipas matjeve shumëvjeçare të stacionit Gryka, rezulton që prurjet e Lumëbardhit të Pejës variojnë nga 3.87m³ /s në 11.15 m³ /s, me një mesatare prej 6.21 m³ /s. Lumbardhi i Deçanit - formohet prej dy lumenjve; Kozhnjerit (djathtas) dhe Marjashit (majtas). Ka sipërfaqe

të pellgut ujëmbledhës prej 278,3 km² (Labus, 1979). Është lum malor dhe formon luginë të ngushtë dhe të thellë me pjerrësi mesatare në rrjedhën e sipërme 80 m/km, ka gjatësi 40.4 km. Sipas matjeve shumëvjeçare të stacionit Deçan, rezulton që prurjet e Lumëbardhit të Deçanit luhaten nga 2.12 m³ /s në 9.41 m³ /s, me një mesatare prej 4.64 m³ /s. Lumëbardhi i Lloqanit - buron nga shpatet e Kurvallës, në lartësi mbi detare 2100m. Shtrati i Lumit të Lloqanit pjesërisht është i rregulluar. Ky lum përshkon fshatrat Hulaj, Lloqan ,Carrabreg i Naltë, Prilep, Rastovicë, Baballoq, Gramaqel dhe Jasiq. Uji nga ky lum shfrytëzohet për ujitjen e tokave bujqësore. Lumi Erenik - ka një sistem mjaft të zhvilluar hidrografik, buron në bjeshkët e Junikut dhe të Vokshit nën Majën Dervish Kam (2256 m) (Pasha,1975). Ka gjatësi rreth 51 km dhe sipërfaqe të pellgut 515,5 km² (Labus, 1979). Në pjesën e sipërme të rrjedhjes krijon një luginë të ngushtë dhe të thellë e cila zgjerohet duke filluar nga Juniku e deri në grykëderdhje në Dinin e Bardhë. Pjesa e sipërme karakterizohet me shkallë të lartë erozive duke bartur dhe depozituar material eroziv në pjesën fushore të tij. Sipas matjeve shumëvjeçare të stacionit Gjakovë, rezulton që prurjet e Erenikut variojnë nga 3.72 m³ /s në 27.05 m³ /s, me një mesatare prej 12.25 m³ /s.




Figura 13 Rrjeti Hidrografik i komunës së Deçanit

Rekomandimet për përmirësimin e furnizimit me ujë:

Në mënyrë që të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë rekomandohen:

- Përmirësimi i sistemit ekzistues të furnizimit me ujë;
- Ndalimi i keqpërdorimeve dhe detyrimi për përdorimin racional të ujit të pijshëm;

- Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm edhe nga pusët private;
- Hulumtimi i mundësive për burime të reja ujore;
- Kërkime për burime të ujit në fshatrat tjera ku nuk ka mundësi të mbulohen nga sistemi tanishëm i ujësjellësit dhe;
- Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Menaxhimi i mbeturinave - Mbeturinat urbane - Në disa pjesë të qytetit dhe vendbanime rurale, të cilat nuk janë të mbuluara me shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe të transportit të mbeturinave deri në deponin rajonale, mbeturinat hedhen në hapësira publike, (hapësirave të pashfrytëzuara), përgjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale, si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin. Gjithashtu, në vendbanimet rurale të Komunës ekzistojnë shumë deponi të egra, shpesh herë nga 2-3 sosh në çdo vendbanim. Duke shkaktuar degradim të pjesëve të gjelbëruara, me pasoja të shumta për shëndetin e qytetarëve, duke sjellë pengesa në lëvizje të lirë të tyre, po ashtu edhe automjeteve. Nga hedhja e mbeturinave janë të dëmtuar sipërfaqe bujqësore afërsisht 10.20 ha. Nga 78 deponitë ilegale të identifikuar janë mbyllur 16 prej tyre. Aksioni për mbylljen e deponimeve ilegale nuk është realizuar plotësisht, për arsye të mjeteve financiare. Qyteti ynë disponon një lokacion për tregun e gjelbër, i cili nuk i plotëson as kushtet minimale, gjithashtu disponojmë edhe më një lokacion për tregun e kafshëve, i cili është në periferi të qytetit, që mirëmbahet dhe menaxhohet nga pronari i pronës që ka lëshuar për treg të kafshëve. Në bashkëpunim me komunën dhe USAID-in është realizuar projekti për furnizim me kontejnerë 2500 ekonomi familjare, është realizuar faza e parë e projektit për pajisje me kontejnerë ekonomitë familjare në Deçan, Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ultë, Llukë të Epërm, Llukë e Ultë dhe Prejlep.

Mbeturinat speciale - Në Komunë tonë problem i theksuar janë mbeturinat medicinale, medikamenteve të skaduara dhe eshtrat e kafshëve. Në gjitha qendrat e mjekësisë familjare nuk kanë incenerator, ndërsa në disa qendra të mjekësisë familjare mungojnë mjete për selektim mbeturinave të përgjithshme nga ato medicinale. Po ashtu, mungon sistemi i organizuar i mbledhjes së vajrave të përdorura, baterive dhe akumulatorëve, gomave të automjeteve, automjete e papërdorshme, mbeturinave bujqësore (bimore dhe shtazore), thertoret (eshtrat e kafshëve, gjaku etj.).

Ndryshimet natyrore - Normal që me ndërtimin e fabrikave të ndryshme do të kemi edhe prishje të peizazhit, do të kemi ndotje gjatë ndërtimit në suaza të caktuara si dhe do të ketë

ndryshim të atij lokacioni, sepse shtohet një ndërtim i ri ku kemi me shumë ndotje nga shkarkimi i ujerave të kanalizimit, po ashtu lëvizjet e makinerive përreth objektit, gazrat ose pikja e vajit në raste të ndonjë prishje, ku këto janë të gjitha shkaktar që mund ta ndryshojnë mjedisin.

Vlen të theksohet se edhe mbeturinat komunale bëjnë ndotje të madhe në ambient dhe natyrë. Sa i përket projektit të fabrikës për ambalazhimin e ujit nuk ka fare ndikim në ambient sepse nuk shkarkohen ndonjë kemikat apo ndonjë substance që mund të ndotë ujë apo dheun, po ashtu nga funksionimi i fabrikës nuk lirohen gazra.

Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimitarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial, mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve, vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit dhe ujit, zhurma).

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në Fabrikën për ambalazhimin e ujit, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produktin që do të ofrojë si dhe për mundësitë e punësimit.

Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin Kryesor të diskutuar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndërtuar objekti i fabrikës së ambalazhimit të ujit. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

5.1 Ndikimet në ajër

Ndotësit e ajrit janë kimikatet, grimcat e pluhurit ose materiet biologjike që shkaktojnë dëmtime ose shqetësime tek njerëzit dhe organizmat e tjerë apo shkaktojnë dëme në mjedisin natyror në atmosferë. Efektet shëndetësore shkaktuar nga ndotësit e ajrit klasifikohen si të ndryshme fiziologjike dhe biokimike të lehta deri në vështirësi në frymëmarrje (raspiatore) dhe probleme të ndryshme kardiale. Burimet e ndotjes së ajrit mund të jenë natyrore ose antropogjene. Ndotësit kryesor të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit si NO_x, SO₂ dhe benzeni emitohen nga djegia e lëndës fosile për energji dhe transport. Njëri ndër problemet kryesore që

paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve si: CO₂, NO_x, SO₂, CO. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda si: Pb etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotje nga qarkullimi i automjeteve është përgjatë rrugës kryesore Pejë-Deçan-Gjakovë. Në ndotje të ajrit ndikon edhe djegia mbeturinave dhe deponitë ilegale. Dendësia e trafikut, mungesa e hapësirave për parkim, makinat e vjetruara, mungesa e hapësirave të gjelbëruara apo mirëmbajtja jo e mirë e tyre janë burim i ndotjes së madhe të ajrit. Sektori i industrisë nuk punon që nga pas lufta.

5.2 Ndikimet në tokë

Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë fabrike nuk do të kenë ndikim të madh në tokë, prapëseprapë në lokacionin ku është ndërtuar fabrika, nuk është bërë ndonjë aktivitet i cili do të kishte dëme të theksuara në dëmtimin fizik të tokës. Në tabelën e mëposhtme shihen të gjitha ndikimet në tokë:

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Ndikimi	Prioriteti
Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore.	-Lëvizje demografike e pakontrolluar dhe; -Ndërtimet në toka bujqësore.	E lartë	-Ndërimi destinacionit të tokës bujqësore, në ndërtimore pa asnjë kriter; -Ulja e nivelit të zhvillimit të bujqësisë dhe; -Ulja e rendimenteve të prodhimit.	***
Përmytjet e tokës bujqësore.	-Mospastrimi i shtretërve të lumenjve dhe; -Mos mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes dhe kanaleve kulluese.	E lartë	-Humbja e sipërfaqes së tokës punuese dhe; -Ndryshimi i përdorimit të tokës.	***
Ulja e nivelit të punësimit në bujqësi.	-Emigracioni fshat-qytet; -Mungesë subvencionesh dhe; -Mungesë e tregut të shitjes.	E mesme	-Të ardhura të ulëta dhe; -Zvogëlon cilësinë e tokës dhe ndikon negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm.	**
Tokat pyjore Problemi i pakësimit të sipërfaqeve të gjelbëruara.	-Prerja pa kriter i pyjeve dhe; -Kullosja e tepërt.	E lartë	-Ndikimi në peizazhe; -Ndikim në cilësinë e tokës humusore dhe; -Ndikim në cilësinë e ajrit.	***
Degradimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në hapësirat publike.	-Hedhja e mbeturinave dhe; -Mosmirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese.	E lartë	-Ndikimi në peizazhe; -Degradim i hapësirës publike dhe; -Ndotja e tokës.	***
Tokat erozive Bimësi e pakët, ndikim në erozion.	-Prerja ilegale e pyjeve; -Mungesa e pendëve mbrojtëse dhe; -Hedhja e mbeturinave në vendet e pacaktuara.	E lartë	-Përmytja e vendbanimeve në kohë reshesh dhe; -Ulja e rendimenteve të kulturave në bujqësi.	**
Tokat ndërtimore Shfrytëzim joracional i tokës ndërtimore.	-Mos zbatimi i ligjeve; -Mungesë e planeve rregulluese.	E lartë	-Pengon mundësinë e zhvillimit të prioriteteve; -Parregullsi urbanistike; -Zvogëlon cilësinë e mjedisit dhe; -Ndotjen e tokës.	**
Trafiku Mungesa e vend-parkingjeve.	-Numri i automjeteve në rritje.	E mesme	-Rritja e nivelit të ndotjes në ajër; -Rritje e zhurmave në mjedis; -Dëmtimi i trotuareve dhe; -Rritja e pasigurisë së këmbësorëve.	**


5.3 Ndikimet në ujë

Në Komunën e Deçanit ndotja shkaktohet kryesisht nga hedhurinat e pa trajtuara dhe nga derdhja e ujrave të zeza. Viteve të fundit, ndotja e rrjedhave ujore ka filluar të shkaktohet edhe nga aktivitetet e tjera, si komerciale, ashtu edhe të rekreacionit.

Lumenjtë - (përroskat, ujërat sipërfaqësore). Ndotja e ujit dhe degradimi i lumenjve dhe përroskave nga komuniteti dhe faktorët natyrorë.

Ndotja e vazhdueshme nga derdhjet e ujrave të zeza dhe mbeturinat dhe; Vërshimet si pasojë ngushtimet të shtratit të lumit dhe hedhjes së mbeturinave.

- Lumëbardhi i Deçanit” Degradimi i rrjedhës së lumit dhe ulja e nivelit të ujit, dhe; Derdhja e ujrave të zeza të pa trajtuara.
- Sistemi i ujitjes dhe; Dëmtimi i kanaleve të ujitjes.
- Rrjeti i kanaleve të ujitjes; Mosmirëmbajtja e kanaleve të ujitjes dhe; Sistemi i vjetruar i kanaleve.
- Ujërat nëntokësore dhe; Ndotja e ujrave nëntokësore nga ujërat e zeza.
- Burimet e ujrave dhe; Mosmirëmbajtja e hapësirave përreth burimeve.
- urimet e ujrave termominerale (uji mineral).



Kompania ne fjale ka ndërtuar impiantin për trajtimin e ujerave te ndotura me vëllim 74 m3 nga fabrika e ambalazhimit te ujit dhe nuk do te kemi ndotje ne ujera sipërfaqësor apo nëntokësor.

6. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Shpyllëzimet masive, prerjet e pyjeve, zjarret, gjuetia e pakontrolluar, janë disa faktorë që rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto vjen deri të humbja e sipërfaqeve pyjore, zvogëlimi i fondit të faunës, që ka përfshirë ekosistemin natyrorë është ndër problemet më kryesore për ruajtjen e mjedisit–natyrës në Komunën tonë. Reduktimi sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i tyre është si pasoj e shfrytëzimit pa kriter i resurseve natyrore në Komunën tonë. Si pasoj e këtyre veprimeve, vije deri të zvogëlimi dhe zhdukja e shumë llojeve të veçanta bimore dhe shtazore. Fauna e “Bjeshkëve të Deçanit” është e shumëllojshme më shumë lloje që janë karakteristike të kësaj zone, siç janë: rrëqebulli, ariu i murrme (urgus actros), dhia egër (rupicapra rupicapra), ketri (scirflus vulgaris), derri i egër (sus strofa), ujku (canis lupus), macja e egër (fellis silverscis), kaprolli (caprelous), lepuri (lepus europaeus), etj., si dhe lloje të shpezëve si: shqiponja e maleve, pulegra e madhe etj. Për këto lloje të faunës shqetësuese është gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit, si dhe mbledhja e rizomave, zhardhokëve dhe organeve të tjera riprodiktive të këtyre bimëve. Për tejkalimin e kësaj gjendje nevojitet hartimi i strategjive të ndryshme për ruajtjen e biodiveristetit, implementimi i ligjeve ekzistuese në teren, duke përfshirë edhe fushatat për ndërgjegjësimin e banorëve për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës. Masivi i bjeshkëve që i takojnë këtij rajoni ofrojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit gjatë sezonit dimëror dhe veror, gjuetisë dhe peshkimit. Zhvillimi i gjuetisë dhe peshkimit mund të bëhet pikërisht në ato zona ku fondi i faunës është i pasur më llojet shumta të kafshëve të egra. Rajonet më potenciale që ofrojnë për zhvillimin e gjuetisë janë: “Kozhnjerri”, “Bjeshka e Baballoqit”, “Bjeshka e Strellcit”, “Bjeshka e Prejlepit”, “Maja e Ropsit”, ndërsa peshkimi mund të zhvillohet përgjatë shtratit të “Lumëbardhit të Deçanit” dhe “Lumëbardhit të Lloqanit”. Si rrjedhojë e ndotjes së madhe të ujërave të lumenjve fauna dhe flora e tyre është e rrezikuar mjaftë.

7. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku gjendet fabrika e lartpërmendur nuk ka ndikim negative në popullatën e zonës. Pasi që lokacioni ku është duke vepruar fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, si dhe “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k., e cila gjendet ne fshatin Isnig e cila nuk ka shtëpi afër dhe se nuk

krijon shqetësim për banorët lokal. Në të kundërtën, ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal në këtë fabrikë, njëkohësisht sjell produkt shumë të mirë në tregun e Kosovës në përgjithësi.

8. Ndikimet nga zhurma

zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme për këtë zonë. Komuna nuk ka pajisje për matjen zhurmës. Burimi kryesor i zhurmës vjen nga komunikacioni dhe ka efekt negativ. Në planin zhvillimor të Komunës janë planifikuar zonat e mbrojtura nga zhurma. Në këto zona nuk do të lejohet ndërtimi dhe lejimi i aktiviteteve të subjekteve afariste, që shkaktojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara me ligj. Këtë e vërteton edhe hulumtimi në terren, ku ndotja nga zhurma është theksuar si ndotësi më i madh, me 50 %. Në rrugët kryesore dhe rrugëve lokale duhet të bëhet mbjellja e drurëve përgjatë shiritave të gjelbërimit me qëllim të amortizimit të zhurmës.

9. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve nga fabrika për ambalazhimin e ujit, vlerësohen si raste të izoluar. Nuk ka aktivitete me materie të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi.

Bazuar në Udhëzimin administrativ 04/2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme, në rastin kompanisë në fjalë nuk ka aksidente të mëdha, sepse nuk përdor substanca të rrezikshme.

10. Erozioni

Kjo dukuri në Komunën tonë është prezent në viset malore dhe përgjatë lumenjve. Si pasojë e faktorëve natyrorë, siç janë: kushtet klimatike, përbërja litologjike e korës së tokës, pjerrësia e terrenit, shpejtësia e rrjedhjes së ujit, kanë ndikim në shfaqjen e proceseve erozive. Gjithashtu, veprimet e shkaktuara edhe nga faktori njeri si: shpyllëzimi, dëmtimi i brezit mbrojtës përgjatë lumenjve, mbeturinat, eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, rritja e sipërfaqes së urbanizuar dhe veprimet e tjera, kanë ndikuar në rritjen e shkallës së erozionit. Janë dy periudha kohore ose stinë të vitit, që karakterizohen më vërshimet: Stina e dimrit/pranverës për shkak të reshjeve të shumta të borës dhe shiut, dhe stina e vjeshtës për shkak të reshjeve të shumta të shirave. Pothuajse të gjitha fshatrat e Komunës së Deçanit, pak a shumë, janë të prekura nga rreziku i vërshimeve, qoftë atyre pas stuhisë në zonat malore, atyre pas shirave të vazhdueshme në zonat fushore apo vërshimeve pas shkrirjes së borës të shoqëruara më mot të ligë.

Vendet më të rrezikuara nga erozioni dhe vërshimet në Komunën tonë janë: Lumi i Lloqanit që kalon në këto lokalitete duke shkaktuar zona vërshuese-Fushat në lindje të Prejlepit, Rastovicës, fusha Devoll e fshatit Baballoq, lagjet Regjaj dhe Mushkolaj në fshatin Gramaqel dhe Jasiq i Ri, nga ku pastaj kalon në fshatrat e Komunës së Gjakovës. Lumbardhi i Deçanit - Nga Ura e Demës, duke përfshi fushat në veri të Deçanit, Llukë e Epërm dhe Ultë, Lumbardhë, Kotradiq dhe Vranoc. Prroni i Behovcit - Nga lagja Hajrizaj vazhdon të Zalli Strellcit, Isniq (Lagja Bruqëve) dhe fshati Dubovik. Prroni i Durakuat - Pjesën veriore të fshatit Strellc i Epërm, pastaj aksi i magjistrales StrellcLubeniq.

11. Pasuritë Materiale

Pasuritë minerale, përveç tokës, fondit të pyjeve dhe ujit, janë mjaft të kufizuara, vlerësimi i kushteve gjeologjike varet kryesisht nga shkalla e hulumtimit të pasurive minerale. Më i përhapur është guri gëlqeror, por nuk shfrytëzohet aq shumë, rëra dhe zhavorri është shumë i përhapur në shtretërit e lumenjve, gjithashtu i përhapur është guri i mermerit, që gjendet në Grykën e Deçanit. Meqë hulumtimet po bëhen vazhdimisht, mund të priten informacione të sakta nga hulumtimet e reja.

12. Trashëgimia Kulturore

Territori i Deçanit është i pasur me monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Vendet më interes të madhe janë, lokalitet arkeologjike parahistorike në Vranoc të Vogël, Gllogjan, Strellc i Epërm, Rastovicë, Irzniq, dhe Baballoq, monumentet myslimane, kullat, monumentet kristiane, si dhe mullinjtë. Identifikimi i vendeve me rëndësi arkeologjike janë në: Llukë e Epërm, Lëbushë, Kisha Selishtave, Rrazhga, Qelia, Shpella e madhe, Balleja Kozhnjerri, Carrabregu etj. Më interes të madh në Komunën tonë kemi një numër të madhe të kullave, të kompleksit të kullave në disa fshatrave të Komunës së Deçanit, siç janë kompleksi i kullave në Isniq dhe Dranoc, si dhe një numër i kullave në fshatrat e Deçanit. Ndër kullat më të njohura janë kulla e Osdautajve dhe ajo e Kuklecëve në kompleksin kullave në Isniq, kulla e Demukajve dhe Mushkolajve në Deçan, Kulla e Mazrekajve dhe Binakajve në Kompleksin e Kullave në Dranoc, Kulla e Ramë Shabanit në Prapaqan, Kulla e Ali (Demë) Gecit në Llukë të Ulët, Kompleksi i Qelisë, si dhe një numër i kullave në pjesët e tjera të Komunës tonë. Objekte të tjera kulturore historike janë edhe xhamitë e vjetra në Komunën tonë të ndërtuara më një arkitekturë të veçantë autoktone shqiptare, siç janë: Xhamia në Deçan, në Carrabregun e Epërm, në Dranoc dhe ajo në Isniq. Përpos këtyre monumenteve, kemi edhe mullinjtë në fshatin Isniq dhe Deçani të ndërtuar në arkitekturë autoktone dhe që punojnë dhe vizitohen deri në ditët e

sotme. Si monumente të tjera duhet cekim Manastirin e Deçanit, objekt me një arkitekturë të veçantë dhe kompleks në pjesën e hyrjes në Grykën e Deçanit dhe shumë atraktive për vizitorë. Sipas gojëdhënave, përreth kishës së sotme, gjendeshin dy-tri fshatra që shtriheshin rrëzë maleve e deri të Kershë i Mark Gegës (mikrotoponim), këto vendbanime 2-3 km, sipër manastirit gjenden të ndërtuara afërsisht dyqind deri treqind vjet para kishës së sotme - “Kulla e Qelisë”⁷. Lokaliteti “Kulla e Qelisë”, shtrihet në pjesën shkëmbore, rrëzë maleve të Isniqit, respektivisht mbi Manastirin e Deçanit. Përbrenda lokalitetit “Kulla e Qelisë” ekzistojnë edhe gjurmët e një objekti sakral, i cili po ashtu i ka rezistuar kohës. Në këtë lokalitet janë gjendur gjurmë të disa afreskeve. Po ashtu, në afërsi të “Kullës së Qelisë”, sot gjenden gjurmët e ruajtura shumë mirë të një godine e cila është e ndërtuar prej gurëve të vegjël e të gdhendur dhe të ruajtur mirë. Kjo godinë është e mbuluar me qemerë të gurit të cilat janë të ruajtura mirë. Edhe dyshemeje e kësaj godine është e shtruar me gurë të gdhendur. Në këtë lokalitet arkeologjik janë gjeture edhe fragmente shumë të rëndësishme për kohën, përmes të cilave mundet të bëhet edhe datimi i këtij lokaliteti të lashtë me vlera historike. Monumentet kulturore-historike dhe arkeologjike paraqesin për Komunën tonë një pasuri, të cilën duhet në të ardhmen të mbrohen dhe shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit.

13. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

- a) Ndërtimi dhe Ekzistenca e projektit deri me tani nuk ka shkaktuar ndonjë ndikim në mjedis apo pasoje. Duke u bazuar në atë se projekti është i natyrës së përhershme, nuk mendojmë se në raste të demolimit do të kemi pasoja shumë të rënda për arsye se projekti është i tipit montazh dhe shumë lehtë mund të demolohet.
- b) Për ndërtimin e objektit, është shfrytëzuar sipërfaqja e tokës e po ashtu është shfrytëzuar dhe uji i cili është i nevojshëm gjatë ndërtimit e po ashtu edhe pas ndërtimit. Sa i përket ndikimeve përpos që ka ndikuar në nxënien e sipërfaqes së tokës ndonjë ndikim tjetër nuk ka patur.
- c) Në fabrikën për ambalazhimin e ujit natyral “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k. nuk ka emetim të zhurmës, e po ashtu edhe të dridhjeve, ndërsa sa i përket dritës nxehtësisë dhe rrezatimit janë në të mirën e kompanisë sepse nuk përdoret energji elektrike për ndriçim dhe nxehtësi. Tani është fillimi i kompanisë dhe nuk ka pasur asnjëherë probleme me mjedis apo inspektorat mjedisor. Kompania nuk bën ndotje as nga mbeturinat komunale sepse ato ka planifikuar ti ruan në kontejner të posaçëm deri sa kompania e licencuar vjen ti marrë ato dhe se nuk bën hedhjen e tyre në ambient.

- d) Kompania “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k. ka marrë të gjitha masat për ruajtjen e shëndetit të njeriut, për arsye se objekti i kompanisë është shumë i qëndrueshëm dhe mund të përballojë fatkeqësitë natyrore siç janë tërmetet, erërat dhe vërshimet, ndërsa sa i përket zjarrit kompania ka marrë të gjitha masat për fikjen e zjarrit ku ka të ndërtuar hidrantët e ujit si dhe është pajisur me aparate për fikjen e zjarrit.
- e) Sa i përket zonave me rendësi të veçante, fabrika e ambalazhimit të ujit natyral, nuk rrezikon ndonjë zone të veçante apo burim natyror.
- f) Ky projekt nuk do të ketë ndikim të madh në natyrë për sa i përket gazrave serrë, për arsye se kamionët dhe të gjitha makineritë që përdoren brenda në fabrike janë me gazra me të lartë se Euro 4 të cilat lejohen për përdorim dhe se nuk kanë ndikim në cenueshmerinë e projektit dhe po ashtu nuk kanë ndikim në ndryshime klimatike.
- g) Pasojat e mundshme mund të vijnë nga prishja e kamionëve, derdhja e karburanteve të makinave, nga sistemi elektro-energjetik, sa i përket pasojave ndërkufitare nuk ka fare pasojë sepse është në qendër të komunës dhe nuk bën kurrfarë ndotje që të ndikojnë në fqinje. Pasojat pozitive janë ato që kompania në fjalë ka planifikuar të punësojë mbi 10 punëtorë sa për fillim dhe pastaj ta rrisë fuqinë punëtore dal nga dal. Ndërsa pasojat negative nuk ka fare.

Për sa i përket mbrojtjes së mjedisit kompania ka marrë të gjitha masat për mbrojtjen e Ajrit (nuk përdoren makineri të vjetra), ujit (shkarkohet në impiant dhe trajtohet) dhe tokës (nuk kemi rrjedhje të derivateve në tokë).

14. PERSHKRIMI I METODAVE PËR VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat të cilat janë përdorur për Vlerësimin e pasojave Mjedisore paraqiten si më poshtë:

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike menaxhimi i trajtimit të çështjeve mjedisore. Si e tillë, ajo plotëson dhe përforcon një metodë sistematike në menaxhimin e përgjithshëm të një organizate; dhe organizatat me një menaxhim të shëndoshë përgjithësisht kanë një performancë më të mirë përmes një metode proaktive dhe të përgjithëshme për zgjidhjen e aspekteve të veprimeve të saj. E kundërta e menaxhimit sistematik është reagimi ndaj vendimeve të marra rregullimi i gjërave kur ato prishen, të kuptuarit se si duhet vepruar kur ka një kërcënim të gjobave dhe padive ose kur përballesh nga konkurrentë më të efektshëm. Marrja e vendimeve të shpejta rrallë është një menaxhim i mirë. Në disa raste, organizatat i përfshijnë Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit, sepse ata tashmë e kishin një sistem të mirë menaxhimi; në raste të tjera Sistemi i Menaxhimit Mjedisor çon në

një menaxhim të përgjithshëm më të mirë duke hapur rrugën përmirësimit të përgjithshëm të veprimeve, dhe futjen e praktikave të mira të menaxhimit aty ku ato nuk kanë ekzistuar më parë. Në rastin e Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit, ka edhe përfitime të veçanta: kursime në kosto, përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme, përmirësimi i marrëdhënieve me autoritetet, zvogëlimi i rrezikut në aspektin e detyrimeve mjedisore, përmirësimi i motivimit të punonjësve, përmirësimi i shëndetit në punë dhe një performancë më të mirë mjedisore.

Kursime në kosto: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kërkojnë praktika për parandalimin e ndotjes, që në mjaft organizata sjellin kursime financiare. Në një fabrikë pa aktivitete të mëparshme mjedisore, shpesh gjysma e ndotjes mund të parandalohet me investime të vogla dhe me procese të thjeshta përmirësimi ose me një qeverisje të mirë të brendshme. Në vendet Evropiane, tarifat e nënshtruara të shkarkimit dhe tarifat për hedhjen e mbeturinave janë shpesh herë mjaft më të larta se kostoja e aktiviteteve për parandalimin e ndotjes, në këtë mënyrë gjëndërohen përfitime financiare. Gjithashtu veprimtaritë dhe teknologjitë për të përmirësuar rendimentin e energjisë, si sistemet efektive të ndriçimit apo gjeneratorët elektrike dhe pompat shpesh janë me leverdi. Kjo do të thotë se ato gjenerojnë kursime në kosto.

Zvogëlimi i rrezikut: Menaxhimi sistematik i rrezikut është një detyrë e përgjithshme për çdo organizatë, dhe një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të mbështetë menaxhimin e rreziqeve nga dhe drejt mjedisit, që mund të parashtrojnë një rrezik për të ardhmen e vetë organizatës, p.sh. nëpërmjet emetimeve që nuk janë të pranueshme për mjedisin ose aksidente që mund të çojnë në detyrime mjedisore ose dëmtim të reputacionit. Shqyrtimi fillestar mjedisor është gjithashtu një vlerësim i rreziqeve mjedisore, duke qenë se ai vlerëson pasojat dhe mundësinë e ndikimeve mjedisore. Plani i veprimit që rrjedh, dhe aktivitetet e tjera të zbatimit të sigurojnë mjetet për të menaxhuar këto rreziqe, duke u përpjekur në reduktimin si të mundësive të tyre dhe të efekteve negative.

Përputhje me legjislacionin: Organizatat në Ballkan dhe Evropë, kryesisht ato të përfshira në prodhim, veprojnë në mjedis mjaft të rregulluar: ata duhet të pajtohen më një legjislacion mjedisor të komplikuar. Gjithmonë e më shumë, aktivitetet e rrezikshme për mjedisin kanë nevojë për leje mjedisore. Për një organizatë, pajtimi me legjislacionin mjedisor është një detyrë e rëndësishme, meqenëse mos-pajtimi mund të çojë në detyrime dhe pasoja ligjore për përfaqësuesit ligjorë të organizatës – drejtuesit e lartë të saj. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë ligjore, pasi ato sigurojnë një bazë për identifikimin e legjislacionit të përshtatshëm, kërkesat e zbatueshme dhe kontrollon përputhshmërinë brenda

organizatës. Kjo metodë sistematike me përputhshmërinë ligjore ndihmon gjithashtu në përmirësimin e marrëdhënieve të organizatës me autoritet mjedisore.

Marrëdhënie më të mira me publikun e gjerë: Aktivitetet e organizatave jo qeveritare dhe protestat publike kundër projekteve që mund të dëmtojnë mjedisin, tregojnë se ndryshimet në shoqëri po ndodhin në nivel global dhe lokal. Konventa Aarhus ndihmon publikun që të ketë një zë në vendimet politike që prekin cilësinë e këtij mjedisi, i ofron publikut akses të lirë në informacion, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e gjykimit për çështjet mjedisore. “Palët e interesuara” si rezidentë, grupet e interesit, media, klientët dhe çdo lloj grupi tjetër apo individ me interes në një çështje, janë tani pjesë e realitetit të një organizate, dhe mënyra më e mirë për tu sjellë me ta është fitimi i besimit nëpërmjet një informimi dhe komunikimi të rregullt dhe të besuar. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ju ndihmon në përgatitjen e të dhënave dhe informacionit që ju duhen për këtë proces komunikimi, ndërsa certifikatat dhe raportimi i rregullt do të mbështesin procesin e fitimit të besimit.

Përmirësimi i motivimit të punonjësve: Një nga rezultatet më të paparashikuara në anketat e organizatave që kanë zbatuar Sistemet e Menaxhimit Mjedisor është përmirësimi i motivimit të punonjësve. Punonjësit përfitojnë drejtpërdrejt nga efektet anësore si përmirësim i shëndeti në punë dhe i kushteve të sigurisë, por gjithashtu ata kujdesen për mjedisin.

Përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme: Ka dy tipe kryesore presionesh që do të ndryshojnë tregjet e së ardhmes: Së pari, kufizimet e botës natyrore – çështje si ngrohja globale, pamjaftueshmëria e ujit dhe humbja e biodiversitetit- do të ndrydhin veprimet e bizneseve. Së dyti, bizneset përballen me një spektër në rritje të klientëve që janë të shqetësuar për mjedisin. Ato biznese që përballen më mirë dhe që i gjejnë një zgjidhje këtyre sfidave, do të mundin konkurrentët e tyre. Duke rritur ndërgjegjësimin mjedisor brenda organizatës suaj, një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të ndihmojë në zbatimin e hapave të nevojshme si eko-projekti, në mënyrë që të zhvillohen procese dhe produkte që do të jenë të përshtatshme për tregjet e së nesërme, të cilat do të jenë më të ndërgjegjësuara për mjedisin.

15. PERSHKRIMI I MASAVE

Me poshtë do ti përshkruajmë te gjitha masat që duhet marrur kompania për t'ju shmangur, parandaluar, zvogëluar apo mënjanuar pasojat negative në Mjedis:

16. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga Fabrika për ambalazhimin e ujit, nga kompania “Tahirsylaj Mineral” SH.P.K. në fshatin Isniq Komuna e Deçanit, në sezonat me temperatura të larta operatori në fjalë të mirëmbaje dhe ujite në mënyrë të vazhdueshme sipërfaqen e tokës ku operon në mënyrë që të mos krijohet pluhuri, duhet të i kushtohet rëndësi edhe pajisjeve mekanike që përdoren gjatë procesit të punës, makinat që përdoren për transport të mos të lirojnë gazra dhe të ndotet ajri, mirëpo ato të mirëmbahen në mënyrë të rregullt, të mos lihen të ndezura pa nevojë e të lirojnë gazra, gjithashtu kujdes maksimal duhet të ushtrohet gjatë procesit të transportit të ujit të ambalazhuar, që pluhuri mos të kalojë në ajër dhe kështu të shkaktohet ndotje e ajrit. Mirëpo nga procesi i ambalazhimit nga fabrika në fjalë mund të themi lirisht se ndotja e ajrit është minimale kur kihet parasysh sasia e madhe e ujit që përdoret për gjatë këtij procesi.

Megjithatë gjatë operimit do të merren masat:

- Mirëmbajtje e hapësirës së fabrikës për ambalazhimin e ujit natyral,
- Kujdesi maksimal gjatë procesit të transportit, mbushjes dhe përgatitjes së produktit final para shitje,
- Parandalimi i djegies së mbeturinave dhe regjistrimi i automjeteve pa filtër,
- Ngritja e cilësisë së pastrimit të sipërfaqeve manipuluese të fabrikës,
- Mirëmbajtjen e rregullt të makinerisë së punës dhe makinerisë lëvizëse-motorike.

17. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe më lart nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikime në tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së parcelës ku operon fabrika ambalazhimin e ujit natyral, “Tahirsylaj Mineral” SH.P.K., është e zonë e gjelbëruar dhe pjesa tjetër ku ka lëvizje motorike është e shtruar me Asfalt. Ndotja e ujit mund të vijë nga larja e pajisjeve për ambalazhimin e ujit natyral, mirëpo fabrika në fjalë këto ujëra nga procesi i larjes i grumbullon dhe i dërgon në impiantin e dedikuar për trajtim të ujerave të ndotura me vëllim deri në 32 m³, i cili është ndërtuar nga përfaqësuesit e kompanisë. Me pastaj fabrika për Ambalazhim të ujit natyral, ujerat pas trajtimit shkarkohen në rrjetin e kanalizimit publik. Në

fakt, në afërsi të hapësirës ku do të ushtroj aktivitetin e saj fabrika nuk ka burime sipërfaqësore të ujit të cilat përdoren për pije dhe burime të ujërave nëntokësore të cilat do të mund të dëmtoheshin nga aktivitetet e kësaj veprimtarie dhe me këtë mund të konkludojmë se ndikimet mjedisore do të jenë minimalë.

Investitori ka plotësuar të gjitha kushtet mjedisore që kërkohen në Ligjin për VNM.

Gjithashtu me qëllim të evitimit të ndikimeve tjera në ujëra, investitori duhet dhe do të zbatojë në përpikëri të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe burimeve tjera të ujit.

18. Masat për mbrojtje nga zhurma

Fabrika për Ambalazhimin e ujit, “Tahirsylaj Mineral” SH.P.K., gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij nuk shkakton zhurmë ose një zhurmë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku ushtron aktivitetin e tij fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, është larg rrugës kryesore dhe larg shtëpive në një distancë mbi 190 m, prandaj zhurma që krijohet nga fabrika është thuajse me e vogël se ajo e komunikacionit, dhe nuk paraqet ndonjë shqetësim të madh. Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rendësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.

19. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcela në lokacionin në të cilën fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, pritet të ushtron aktivitetin e vet, siç është cekur edhe më lart është mjaft e përshtatshme për këtë veprimtari ngase gjenden në zonën rurale të fshatit Isniq të Komunes së Deçanit, larg shtëpive dhe rrugës kryesore, prandaj dhe nuk pritet ndikim negativ në peizazh, florë dhe faunë e vendbanimit në fjalë dhe regjionit në përgjithësi.

20. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin e saj fabrika për ambalazhimin e ujit natyral ka shtëpi të banimit të ndërtuara por ato janë mbi 190 metra larg fabrikës dhe se nuk ndikon negativisht. Gjatë fillimit të punës së ndërtimit të fabrikës, pronaret

e kompanisë i kane njoftuar gojarisht te gjithë banoret ne afërsi për fillimin e ndërtimit te fabrikës se re për ambalazhimin e ujit.

21. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund te ndodhin gjatë aktivitetëve të fabrikës se ambalazhimit te ujit natyral, mund të vlerësohen si raste të izoluara. Për te mos ardhur deri te ndonjë aksidenti eventual investitori paraprakisht, duhet qe ti merren te gjitha masat adekuate për pengimin e aksidentëve. Rreziku me i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet elektrike te fabrikës.

22. Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial te vogla për ndotjen e kualiteti të ajrit.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë erërave te forta te cilat mund e bartin pluhurin nga sipërfaqja e parcelës, si dhe nga ndikimi nga djegia e derivateve ne makineria punuese dhe ato lëvizëse, lënda djegëse për ngrohje etj.	Mirëmbajtje e sipërfaqeve te parcelës, Mirëmbajtja e makinerisë 10se, Mirëmbajtja e makinerisë lëvizëse dhe mos ndezja e motorëve te tyre pa nevojë, Përdorja e lendes ngrohës miqësore me ambientin etj.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston te dheu dhe ujërat nëntokësore	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i keq menaxhimit të ujërave te shkarkuara nga procesi i ambalazhimit.	Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral “Tahirsylaj Mineral” SH.P.K., e ka te ndërtuar impiantin për trajtimin ujerave ndotura te shkarkuara nga procesi i pastrimit dhe punëtorëve.
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat	Potencial minimal, nuk ka zona te rrezikuar ose në zhdukje.	Sipërfaqja ku është ndërtuar Fabrika e ambalazhimit te ujit, është sipërfaqe e vogël, dhe kjo	Me që në fabrikën per ambalazhimin e ujit, eshte zone rurale afër zonës urbane dhe nuk ka florë dhe faune shume te zhvilluar dhe për rrethe saje, në

e mbrojtura të natyrës)		nuk mund të ndikoj në shkallën e mikrosistemit.	përgjithësi rriten dhe zhvillohen llojet e ndryshme të florës dhe faunës. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikim është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
Zhurma	Potencial minimal	Nga ky aktivitet për Fabrikën e ambalazhimit të ujit natyral “Tahirsylaj Mineral” SH.P.K., ka potenciale të vogla të shkaktimit të zhurmë	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim të madh në ambientin jashtëm.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes së hapësirës së Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral për rreth tij	Te gjitha pajisjet të cilat mund të kenë ndikime në shëndetin e qytetareve do të kushtohet rëndësi e veçantë në mirëmbajtjen e tyre.

23. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të Fabrikës për ambalazhimin e ujit natyral nga kompania “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k., nuk krijohen mbeturina gjatë procesit teknologjik të ambalazhimit të ujit, në sasi të vogël kemi mbetje të ambalazhes dhe plastikëve, pra kryesisht mbeturina të riciklueshme si dhe përjashtim mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës në Fabrikë. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave kompania pritet të bëjë marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave nga Komuna e Deçanit.

Për mbetje të mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat e riciklueshme do të grumbullohen dhe do të dërgohen ose do të merren nga kompanitë të cilat merren me riciklim,
- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina, ndërsa
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do të trajtohen komform legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.

24. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me Fabrikën për ambalazhimin e ujit natyral nga Kompania “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k., rrezik mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djegë ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrë të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

Po ashtu rrezik tjetër mjedisor mund të kemi nga prishja e makinave të cilat mund të lirojnë vajrat gjatë qëndrimit të tyre në parkingun e kompanisë.

25. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi - Në bazë të gjendjes faktike në terren, pasi që ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore (nuk parasheh përdorim të ndonjë teknologjie po parashihet përpunim i produkteve kimikale) monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme konform ligjeve dhe të njoftohen organet kompetent.

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhimet, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore e cila lëshohet nga MMPHI.

26. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të arrijmë në një përfundim si në vijim:

Fabrika e kompanisë “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k., është përfunduar në vitin 2022 dhe që pritet të ushtroj aktivitetin e saj për ambalazhimin e ujit pas marrjes së lejeve dhe licencave sipas ligjeve në fuqi.

Ndërtimi i kësaj kompanie është në interes:

- të vet investitorit për të përmirësuar kushte të punës, për të ngritur sasinë dhe kualitetin e produkteve;
- në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe
- në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi të një ambienti me të menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe produkte me cilësi të sigurt.

Në rast se Fabrika për ambalazhimin e ujit “Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k., mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, kjo fabrike konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik.

- Duke u bazuar në natyrën e fabrikës dhe aktivitetit të saj, vendndodhjen e Fabrikës, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit **“Tahirsylaj Mineral” Sh.p.k. nga komuna Deçan.**

27. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT:**TABELA E KOST – BENEFITIT TE INVESTIMIT NE , FABRIKEN E LINJËS SË PRODHIMIT TË UJIT**

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Objekti montazh	240,000.00 €
2.	Pllaka e armuar	350,000.00 €
3.	Kulmi nga konstruksioni i çelikut	53,000.00 €
4.	Administrata	40,000.00 €
5.	Pompat e ujit	28,000.00 €
6.	Makina për filtrimin e ujit	24,000.00 €
7.	Makina për dezinfektim	21,000.00 €
9.	Pajisjet për mineralizim	19,000.00 €
10.	Makina për shpëlarje të shisheve	13,000.00 €
11.	Makina për sterilizim të enëve	15,000.00 €
13.	Makina për vulosjen e kapakëve	14,000.00 €
14.	Makina për inspektim të mbylljes	12,000.00 €
15.	Makina për etiketim	16,000.00 €
16.	Makina për mbushje te shisheve	22,000.00 €
17.	Makina për Mbështjellje me Plastikë	11,000.00 €
18.	Makina për paketim	22,000.00
19.	Pajisjet analitike- Laboratori	50,000.00 €
Shuma totali investive:		950.000.00 €

“TAHIRSYLAJ MINERAL” SH.P.K.

28. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori
- [PLVM-Decani:Layout 1.qxd \(unhabitat-kosovo.org\)](#)
- [Tahirsylaj Mineral | Facebook](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP \(rks-gov.net\)](#)
- [OpenStreetMap](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)
-